



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

### Njoftim Përqendrimi

#### Rasti: Përfitim Kontrolli i “Vodafone Albania SHA / Plus Communication SHA”

Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin mbi transaksionin e realizuar midis shoqërisë Plus Communication SHA dhe Vodafone Albania SHA, e shprehur nëpërmjet “Marrëveshjes për transferimin e spektrit” të nënshkruar më datë 18 Tetor 2017, në të cilën synohet transferimi i të drejtës së përdorimit të ½ së spektrit të frekuencave 900 MHz, ½ së spektrit të frekuencave 1800 MHz dhe ½ së spektrit të frekuencave 2100 MHz të ndërmarrjes Plus Communication SHA<sup>1</sup> tek Vodafone Albania SHA.

Marrëveshja në fjalë është pjesë integrale dhe e pandashme e një pakete më të gjerë negociatash dhe marrëveshjes dakortësie për Zgjidhjen me Pajtim midis Vodafone Albania SHA dhe Plus Communication SHA, si dhe Altelecom SHA dhe Plus Communication SHA, të cilat do të përmbushen paralelisht dhe do të jenë objekt vlerësimi nga Autoriteti.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe c, dhe nenin 12, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe do t’i nënshtrohet procesit të kontrollit të përqendrimit.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Vodafone Albania SHA (Blerësi), një shoqëri aksionare, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi KII715005L dhe me seli në adresën: Autostrada "Tiranë-Durrës", Rr. "Pavarësia", Nr. 61, Kashar, Tiranë. Vodafone ushtron aktivitetin e saj për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me Ligjin 9918/2008 "Për komunikimet elektronike" ("Ligji 9918/2008"), aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të Ligjit të lartpërmendur si dhe në përputhje me Autorizimet e lëshuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ("AKEP").
- Plus Communication SHA (Target), një shoqëri aksionare e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 11.06.2009, me NIPT K91811014B, me seli qendrore në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova", Godina e Re, pranë Gardës së Republikës, Kati i 2, Tiranë, Shqipëri. Plus ushtron aktivitetin e saj për ofrimin

<sup>1</sup> Për kohëzgjatjen e mbetur respektivisht, dhënë në përdorim nga AKEP shoqërisë Plus Communication SHA

e shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me Ligjin 9918/2008 "Për Komunikimet Elektronike".

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. "Sami Frashëri", Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).